

Raport i Transparences

“Eriold Janko ” Person Fizik

Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2024

Përmbajtja

- Hyrje
- Struktura ligjore
- Përshkrimi i strukturës drejtuese të entitetit
- Përshkrimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë së praktikës së auditimit
- Deklarata e praktikave të pavarësisë së praktikuesit
- Deklarata për politikën e ndjekur nga praktikuesi i vetëm , për kualifikimin e vijueshëm profesional të audituesit ligjor
- Informacioni financiar
- Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga audituesi ligjor

Hyrje

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim Raportin e Transparencës të audituesit ligjor Eriold Janko P.Fizik Tiranë për vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2024. Aktualisht jemi prej 5 vjetesh në tregun shqipëtar, duke ofruar shërbime në fushën e auditimit, konsulencës dhe shërbimeve financiare. Audituesi ligjor ka përvojë të gjerë pune në ndërmarrjet që operojnë në industri të ndryshme në tregun Shqiptar.

Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me stafin tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që këto organizata kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme.

Ne jemi të dedikuar për t'i shërbyer kërkesave të klientëve në sektorin privat, shoqërive të listuara dhe shoqërive në sektorin publik , përmes ofrimit të një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe këshillimit kontabël e financiar.

Per vitin 2024 Eriold Janko Auditues ligjor nuk eshte anetar i ndonje rrjeti nderkombetar dhe nuk ka te punesuar.

Struktura ligjore

Eriold Janko Person Fizik , eshte rregjistruar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14.04.2008, i ndryshuar.

Auditues Ligjor te rregjistruar ne Regjistrin Publik:

Periudha	Emri	Mbiemri
1 Janar - 31 Dhjetor 2024	Eriold	Janko

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë profesionale cilësore dhe të përsosmërisë së etikës.

Struktura drejtuese

Entiteti administrohet nga zoti Eriold Janko, auditues ligjor i regjistruar në Shqipëri.

Ne jemi të fokusuar në ofrimin e një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe konsulencës.

- Shërbime të Auditimit ligjor e të dhënies së sigurisë
- Shërbime konsulence Tatime & Taksa
- Shërbime kontabiliteti dhe fiskale
- Këshillime financiare
- Shërbime për konsulencë për riskun e biznesit
- Bashkime, ndarje të shoqërive tregtare
- Shërbime të tjera profesionale

Politikat e sistemit të kontrollit të cilësisë

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit.

Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigorozë të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë

Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standarde të larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Audituesi ligjor ka procedura të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

Manualet teknike dhe procedurale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;

- trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të të gjithë partnerëve dhe punonjësve;
- vlerësim vjetor të të gjithë stafit;
- Etika dhe integriteti; ne pranojmë/ vijojmë t'ju ofrojmë shërbime vetëm klientëve që demonstrojnë integritet;

Kjo arrihet përmes vlerësimit të parametrave relativë që kanë të bëjnë me pranimin dhe vijimin e klientëve (Pranimi & Vijimi i Marrëdhënieve me Klientë & Politikat dhe Procedurat e Angazhimeve Specifike të Auditimit) rishikimi i proceseve të cilësisë së shërbimeve të sigurisë për të mundësuar që drejtimi të fitojë siguri se ekzistojnë procedurat e nevojshme, janë duke funksionuar dhe janë efektive (Rishikimi i Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë - "SNMC1 & SNMC 2").

Deklarata e pavarësisë së audituesit

Audituesi Ligjor ruan politika dhe procedura të shkruara mbi pavarësinë, të cilat përfshijnë edhe kryerjen e disa kontrolleve të pajtueshmërisë së pavarësisë në baza vjetore dhe të cilat janë të aplikueshme për praktikuesin.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm të pajtueshmërisë me politikat e pavarësisë, inspektime te pavarësisë dhe procedura të testimit kryhen çdo vit.

Politika për edukimin dhe kualifikimin e vijshëm profesional

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kyç e shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona

Si ofruet shërbimesh profesionale që ofron një gamë të plotë të shërbimeve të auditimit, taksave dhe konsulencës për klientët tanë, është e domosdoshme që cilësia të jetë në themeline gjithçkaje që bëjmë. Kritike për suksesin tonë në arritjen dhe ruajtjen e standardeve tona të cilësisë, janë kualifikimet profesionale dhe trajnimet e audituesit ligjor në procesin e auditimit.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve tanë është i rëndësishëm për suksesin e biznesit tonë dhe aftësinë tonë për të siguruar që cilësia është e lartë në të gjitha fushtat tona të shërbimit. Filozofia jonë e zhvillimit bazohet jo vetëm në trajnime formale, me mësim në vendin e punës por edhe në nivele të rëndësishme të edukimit të vazhdueshëm profesional. Për të mbështetur më tej kulturën tonë të zhvillimit të vazhdueshëm ne kryjmë rishikime të performancës në baza vjetore.

Aftësitë dhe cilësitë personale të audituesit ligjor dhe përputhshmëria e tyre me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionalistë të IFAC (Kërkesat Etike);

Kryerja e auditimeve në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore për raporte cilësore të auditimit;

Objektiviteti dhe pavarësia - kuptimi nga e gjithë shoqëria se reputacioni ynë i fituar me vështirësi varet nga cilësia e punës sonë dhe nga cilësia e vendimeve që ne marrim.

Audituesi ligjor adopton një kuadër të menaxhimit të riskut ku drejtimi është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të kryera dhe siguron zbatimin e procedurave të përshtatshme në baza vjetore. Përmes identifikimit të dobësive të mundshme, merren masa të përshtatshme për të monitoruar plotësisht proceset e kontrollit.

Informacione financiare

Të ardhurat e realizuara nga audituesi ligjor për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është si në vijim:

Sherbimi	Vlera	Ne %
Sherbime Auditimi	1,943,000	38%
Sherbime hartim pasqyra Financiare	300,000	6%
Sherbime te sigurise	580,140	11%
Sherbime kontabiliteti, konsulence	2,277,000	45%
Total	5,100,140	100%

Lista e Njësive ekonomike me interes publik

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat **audituesi ligjor ka leshuar**

lëshuar 1 (nje) opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10091 datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

“Njësi ekonomike me interes publik” janë:

- Të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- Bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;


Shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 17 date 16.01.2019 “Per percaktimin e Shoqerive te tjera Shteterore ose Private te Rendesishme per Interesin e Publikut, per shkak te Natyres se Biznesit, Madhesise ose Numrit te te Punesuarve te tyre”.

Gjatë vitit 2024 audituesi Ligjor Eriold Janko kreu auditimin Pasqyrat e mbyllura ne date 31 Dhjetor 2023 për entitetin me interes public (EIP) si me poshte:

Shoqëria	Aktiviteti
Megapharm shpk	Shoqëri Tregtimi

Pergatitur nga:

Eriold Janko



Rruga Adem Jashari Pall 4, Shk 1,

Tirane – Shqiperi

Mars 2025